KONFERENCË "MARTESAT NËN MOSHË"

Newsletter nr 10, 19 Shkurt 2016

Në kuadër të nismës"Parandalimi i martesave të hershme në Shqipëri" mbështetur nga Fondi Kanadez për Nismat Vendore

Nisma *"Parandalimi i martesave të hershme në Shqipëri" është* zbatuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve në partneritet me Fondin Kanadez për Nismat Vendore. *Faza e parë e nismës* kishte një vështrim specifik të martesave nën moshë mbi komunitetin Rom në zonën e Tiranës. *Në fazën e dytë* u studjua situata në zonat periferike dhe rurale të Vlorës dhe Korçës si dy zona kufitare.

Në përmbyllje të nismës *"Parandalimi i martesave të hershme në Shqipëri"* në 19 Shkurt 2016 u realizua një *konferencë*, nën vëmendjen e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë, Institucioneve Ndërkombëtare dhe Kombëtare si dhe shoqërisë civile.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, një nismë e UNICEF Shqipëri dhe partner i UN, ka zhvilluar një mekanizëm që lejon mbledhjen e informacionit dhe nivel rajoni (Qarku) në lidhje me situatën dhe të drejtat e fëmijëve.

Si pjesë aktive dhe integrale e shoqërisë civile në çdo rajon, Observatori bashkëpunon me aktorë publikë dhe privatë në proçesin e mbledhjes sistematike të të dhënave dhe nxjerrjen e raporteve dhe relacioneve informuese në lidhje me të drejtat e fëmijëve, zbatimin e ligjeve në këtë fushë dhe identifikimin e nevojave për përmirësime.

Konferenca "Martesat nën moshë"

Konferenca u zhvillua në dy sesione:

Paneli i parë u moderua nga Prof. Dr. Arta Mandro, Eksperte e të drejtës familjare dhe të drejtave të fëmijëve, Shkolla e Magjistraturës. Në këtë sesion të konferencës, dhanë deklaratat e tyre mbështetëse:

- *Znj. Gentiana Sula*, Zv. Ministër i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
- *Znj. Elona Gjebrea*, Zv. Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme
- *Z. Gazmend Bejtja,* Drejtor në Ministrinë e Shëndetësisë
- *Znj. Manuela Bello*, Ndihmës Përfaqësuese e UNFPA Shqipëri
- *Z. Marc Antoine Dumas*, Këshilltar në Ambasadën Kanadeze në Romë
- *Znj. Elma Tërshana, Drejtore ekzekutive e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve*

Paneli i dytë u moderua nga Znj. Elida Nuri, UNFPA Shqipëri. Në këtë sesion të konferencës u realizuan edhe prezantimet teknike të studimit "Zhgjendrra e lumturisë së martesës së hershme", i cili mund të gjendet në linkun:

Studimi në shqip:
http://observator.org.al/wp-content/uploads/2016/02/ZEB_Studimi_al_12Shk2016.pdf
Studimi në anglisht:
http://observator.org.al/wp-content/uploads/2016/02/ZEB_Studimi_en_12Feb2016.pdf

Angazhimet gjatë konferencës

Studime që trajtojnë këtë problem shoqërorë të vajzave dhe grave dhe nisma për ndërgjegjësim për parandalim të martesave nën moshë në nivel vendor dhe kombëtar, mund të konsiderohet risi dhe progres në vende si Shqipëria, në të cilën ky fenomen i ka rrënjët e shtrira thellë në histori dhe të ushqyera rishtazi nga faktorë socialë mjaft dinamikë. Nga kërkime rajonale dhe globale, një fokus i veçantë i vihet pasojave të martesës nën moshë të lidhura me: mirëqenien fizike dhe emocionale, të drejtën për edukim dhe zhvillim (personal, profesional dhe ekonomik) dhe trajtimi i tyre në këtë studim paraqet një rëndësi të veçantë për kontekstin shqiptar.

Në kuadrin e KDF dhe CEDAW Shqipërisë i është kërkuar, të marrë në konsideratë çështjen e martesave të hershme dhe të raportojë mbi të. Ndërthurja dhe intensifikimi i përpjekjeve të përbashkëta mbi martesat e hershme në kontekstin shqiptar është nje nevojë imediate.

Ministritë shprehën gadishmërinë e bashkëpunimit të ardhshëm për të minimizuar martesat nën moshë nëpërmjet:

- Rolit më të madh të NjMF-ve dhe NJDF-ve në ndjekjen e rasteve;
- Mbështetje të vajzave-nëna me programe të veçanta sociale;
- Punë individuale me vajzat-nëna;
- Krijimi i lehtësirave në aspektin ligjor;
- Realizimin e një studimi kombëtar duke përfshirë edhe zona në veri të Shqipërisë;
- Ofrimi i disa shërbimeve të veçanta për të rinjtë;
- Fenomeni i martesave të hershme dhe pasojat që sjell duhet trajtuar si një çështje e karakterit ndërsektorial.

Aspektet e shumta të martesës nën moshë si në drejtim të reduktimit të shfaqjes dhe në drejtim të adresimit të pasojave përbën një proces dhënie- dhe- marrjeje mes aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë Qeverinë e Shqipërisë dhe institucionet vartëse, pushtetit vendor si zbatues dhe mbështetës të politikave, të komunitetit të donatorëve të interesuar në çështjet që lidhen me martesat nën moshë, mediave, komunitetit në nivel lokal, si dhe të shoqërisë civile.

Ne jemi të bindur dhe të frymëzuar që bashkëpunimi efektiv ndërmjet aktorëve të sipërpërmendur do të ofrojë një mjedisi shoqëror në të cilin vajzat janë fuqizuar që të kenë një zë më të fortë dhe për të marrë drejtimin e jetës së tyre - "***për të shijuar vajzërinë përpara të qenit nuse!***"

Lista e Shkurtimeve

KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
CEDAW	Konventa për Eleminimin e të gjithë formave të Diskriminimit ndaj Gruas
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë dhe Zhvillimin
NjMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NjDF	Njësia për të Drejtat e Fëmijëve

OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE
Bulevardi "Bajram Curri", Pall "Agimi", Shk 5, Ap 81, Tiranë
Tel: 00355 4 258 987 | e-mail: info@observator.org.al |web: www.observator.org.al